



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1725/ 15 prot.

Datë 02/09/2025

V E N D I M
Nr. 1175/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02/09/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1096/2025, datë 20.08.2025 për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “*Ndërtimi i godinës së Bashkisë*”, me fond limit 108.333.333 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

Ankimues: Operatori ekonomik “Salillari” SHPK, me NIPT J62903125G, me adresë Lagjia “4 Shtatori”, Ish Magazinat, Ura Vajgurore.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dimal.
Adresa: Lagjia “18 Tetori”, Ura Vajgurore.

Subjekt i Interesuar: BOE “Armir” SHPK & “Asi-2A Co” SHPK, me NIPT K82509006P, me adresë Lagjia “Konizbalte”, Ura Vajgurore, Berat

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për Miratimin e Rregullave për Organizimin dhe*

Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 20.08.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1096/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Salillari*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “*Ndërtimi i godinës së Bashkisë*”, me fond limit 108.333.333 (*njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për skualifikimin e operatorit ekonomik “*Salillari*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Salillari*” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2346/5 prot., datë 28.08.2025, me objekt “*Njoftim mbi zbatimin e vendimit të KPP-së nr. 1096/2025, datë 20.08.2025*”, protokolluar me tonën nr. 1725/12 prot., datë 01.09.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Dimal., lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1096/2025, datë 20.08.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “*Salillari*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “*Ndërtimi i godinës së Bashkisë*”, me fond limit 108.333.333

(njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2346/5 prot., datë 28.08.2025, me objekt “Njoftim mbi zbatimin e vendimit të KPP-së nr. 1096/2025, datë 20.08.2025”, protokolluar me tonën nr. 1725/12 prot., datë 01.09.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Dimal., lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1096/2025, datë 20.08.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “Ndërtimi i godinës së Bashkisë”, me fond limit 108.333.333 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1096/2025 datë 20.08.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar statusin e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1096/2025, datë 20.08.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedure e hapur”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “Ndërtimi i godinës së Bashkisë”, me fond limit 108.333.333 (njëqind e tetë milion e

treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

